



# Amfora

albaqeramika



Valdet Deçani

Sivjet mbushëm 24 vjet. Rrita jonë nuk ka pasur të ndalur asnjëherë dhe as ky vit nuk bën dallim në këtë aspekt. Por ajo që e veçon këtë vit është hapja e sallorit të ri në Pejë, ku po ashtu kemi treguar frymën e modernizmit që Albaqeramika mundohet ta përçojë. Ne sot jemi një familje e madhe me rreth 100 të punësuar. E një familje nuk mund të jetë e suksesshme pa angazhimin dhe përkushtimin e secilit. Unë jam shumë mirënjohës për stafin që kemi. Jam shumë mirënjohës që të gjithë keni përqaftuar filozofinë e kompanisë tonë që rrjedh nga një këshillë e babait tonë, njëherit themelues i kompanisë. “Çdo punë të cilën e marrim përsipër, sado e madhe apo e vogël, e rëndësishme apo më pak e rëndësishme, duhet të kryhet me përkushtim të madh”. Këtë këshillë unë dhe vëllai, Fisniku, e aplikojmë me fanatizëm. Andaj edhe jemi mirënjohës për të gjithë ata anëtarë të familjes së Albaqeramikës që e kanë mirëkuptuar dhe janë duke e aplikuar. Në qoftë se punën që e marrim e kryejmë ashtu siç dimë më së miri ajo na jep kënaqësi dhe ajo kënaqësi shprehet edhe në kompani e shoqëri në përgjithësi, si dhe na bën të ndjehemi më të vlerësuar. Me kënaqësi e përsëris se edhe ky vit ishte i suksesshëm për Albaqeramikën. Një ndër sukseset e veçanta është edhe hapja e sallorit të ri në objekt të ri në Pejë. I falenderoj të gjithë që kanë marrë pjesë në realizmin e këtij projekti dhe një falenderim i veçantë shkon për menaxherin e Albaqeramikës në Pejë, Fisnik Dacin, i cili pa kursyer kohën dhe duke lënë anash shumë obligime tjera personale ka punuar në mënyrë që rrjedha e këtij projekti të shkojë ashtu siç duhet. Edhe pas përfundimit të projektit ai po punon pandërprerë për punën e madhe që po na pret përpara. Tjetër falenderim shkon për Armend Krasniqin, menaxher në Prizren, i cili është duke punuar thuasht e panvarur dhe i pa përkrahur nga ne, menaxhmenti i lartë. Armendi ka marrë përgjegjësinë mbi supet e veta dhe është duke punuar për mrekulli. Për pikën tonë më të madhe në Prishtinë tashmë kemi menaxherin e re, Norën, të cilën e uroj për guximin që ka pasë për të pranuar një detyrë që ka shumë përgjegjësi, për sallorin në Prishtinë, i cili padyshim mund të them se është salloni më i veçantë në botë. Këtë e them me mburrje sepse puna e veçantë që bëhet aty, stafi dhe të gjitha së bashku paraqesin një sallor të veçantë. Në këtë rast nuk mund pa e përmendur Liridonin, menaxherin e sallorit për të cilin nuk gjej dot as fjalë adekuate për ta shprehur mirënjohjen që kam për të. Njohja e tij me produktet e sallorit dhe qasja ndaj klientëve është për t’u admiruar. Ne kemi arritur shumë, por kjo nuk do të thotë që kemi mbërritur aty ku dëshirojmë.

Punë dhe projekte të mëdha na presin dhe ju ftoj që të vazhdoni me këtë frymë kontributi e bashkunimi, të punojmë së bashku, në arritjen e sukseseve të radhës.

(Fjalim përshëndetës në ceremoninë e shënimit të 24-vjetorit të Albaqeramikës)

# Koleksione të veçanta nga linja "Premium" e "Kolpaskan"

Përse të mos vendosim standarde të larta për ambientet tona ku jetojmë? Me materiale cilësore, ngjyra të veçanta dhe forma të bukura, një banjo mund të kthehet në një hapësirë jetese krejtësisht të re.

“Milo” nga linja Premium – prodhuesi Kolpa San

Cilësitë që e karakterizojnë këtë koleksion janë:

- Elegancë, ngjyra të buta me latesa klasike të përshtatshme për mjedisin ku jetojmë
- Me një ose dy lavamanë, raft dhe mbajtëse të peshqirit të ndërtuar në raft
- Dush ose vaskë me mundësi të vendosjes kudo dhe që implementohet në shumë mënyra
- Pasqyrë dhe raft
- Koleksioni mund të përshtatet sipas preferencave individuale në shumë ngjyra.



“Atys ” nga linja Premium - prodhuesi Kolpa San  
Vaskat e koleksionit “Atys” sjellin inspirimin e natyrës në shtëpinë tuaj.

Cilësitë që e karakterizojnë këtë koleksion janë:

- Elegancë, kënde të buta dhe të përshtatura në mënyrë klasike për secilën banjo
- Komforditet për një ose dy persona
- Gamë të llojeve të ndryshme



# Partneritet i ri

Kludi - “Vetëm cilësi dhe pasion”

Ne patëm kënaqësinë të ndërtojmë bashkëpunim me kompaninë gjermane KLUDI, e cila në filozofinë e saj zotohet të mos bëjë kurrë kompromis me cilësinë e produkteve që sjell në treg. Qëllimi i tyre është të kënaqin kërkesat e klientëve dhe t'i tejkalojnë pritjet e zakonshme me ide inovative që ofrojnë vlera të qëndrueshme dhe produkte të përsosura. Disenjatori i Kludit gjithnjë e nënvizon: “Dizajni është më shumë se vetëm formë. Dizajni është një kombinim i formës dhe funksionit që ka për qëllim frymëzimin e njerëzve”.





# Albaqeramika rritet me Flux-in

Fillimi i 2017-s, përveç se na gjeti të kënaqur me sukseset e vitit që lamë pas, ishte i veçantë për ne edhe për shkak se zgjeruam biznesin tonë edhe në fusha të tjera, njëra ndër to është ajo e ndërtimtarisë. Zgjerimi ynë në këtë fushë ishte dëshirë e kahmotshme, por ne filluam në pranverë të këtij viti, atëherë kur ishim të gatshëm për të ofruar shërbime të standardeve më të larta në fushën e ndërtimit. Me një fjalë vlerat dhe kualiteti i Albaqeramikës bartet edhe te Flux-i. Objekti i parë i Flux-it është kompleksi banesor “Tilia”, në qendër të Junikut, ndërtimi i të cilit filloi në prill. Ndërtimi i kompleksit është në ndërtim e sipër dhe është duke u zhvilluar sipas standardeve më të larta evropiane dhe brendeve më të njohura botërore. Me ndërtimin e “Tilia”-s, si projekti i parë i Flux-it, synojmë të jemi shembulli i cilësisë dhe komoditetit të një kompleksi banesor në Kosovë.



## Albaqeramika një ndër themelueset e Glam Radio 88.6

Këtë vit ne bashkëthemeluam edhe Glam Radio në frekuencat 88.6, si një radio metropolitane. Startuam me frekuenca lokale për të vazhduar me zgjerim në tërë vendin. Një ndër arsytet të cilat na shtynë të jemi pjesë e Glam Radio ishte vizioni thujase krejtësisht ndryshe nga radiot e tjera. Dy bashkëthemeluesit e tjerë, Ardian Hoxha dhe Gent Efendija, personalitete tashmë të shquara në shumë fusha e sidomos në kulturë dhe në media, na bënë që të jemi shumë optimistë për suksesin e dalluar.



[www.facebook.com/albaqeramika](https://www.facebook.com/albaqeramika)



[twitter.com/ALBAQeramika](https://twitter.com/ALBAQeramika)



[www.instagram.com/albaqeramika](https://www.instagram.com/albaqeramika)



+377 45 60 29 99 Prishtinë  
+386 49 20 50 50 Pejë  
+386 49 21 80 80 Prizren

Në Alba Qeramika mund të paguani edhe me POS të këtyre bankave:



ALBA Qeramika, km IV, magjistralja Prishtinë - Ferizaj

10000 Prishtinë

+386 49 20 60 60

[office@albaqeramika.com](mailto:office@albaqeramika.com)

Implementuar nga

